



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Shtojca 1 e

Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit

Publike

URDHËR MBI ZHVILLIMIN E GJYKIMIT

I.	Karakterit publik i procesit gjyqësor	2
II.	Drejhtësia dhe shpejtësia e procesit gjyqësor	3
III.	Gjuha e punës.....	4
IV.	Sjellja ndaj Trupit Gjyqësor dhe palëve e pjesëmarrësve	4
V.	Kontakti me mediat	5
VI.	Nxjerrja e materialit.....	6
VII.	Redaktimet.....	7
VIII.	Pjesëmarrja e viktimave	9
IX.	Pikat e pakundërshtuara dhe komunikimet midis palëve.....	10
X.	Njoftimi për argumentet mbrojtëse.....	12
XI.	Autenticiteti i provave të propozuara dhe mbështetshmëria në to.....	12
XII.	Paraqitja dhe pranimi i provave	13
XIII.	Mospajtimet lidhur me përkthimin me shkrim dhe/ose me gojë	14
XIV.	Mocionet për prova jogojore	15
XV.	Dëshmitarët	16
	A. Masat mbrojtëse.....	16
	B. Intervista me dëshmitarë të palës kundërshtare	17
	C. Planifikimi i dëshmitarëve dhe i materialit që do të përdoret gjatë marrjes në pyetje	18
	D. Përgatitja e dëshmitarëve.....	22
	E. Rendi i marrjes në pyetje.....	25
	F. Marrja në pyetje e dëshmitarëve	26
	G. Kundërshtimet.....	28
	H. Përdorimi i deklaratave të mëparshme.....	29
	I. Dëshmitarët ekspertë.....	30
XVI.	Konferencat mbi ecurinë lidhur me aspekte procedurale.....	31
XVII.	Prania në sallë të gjyqit dhe përfaqësimi nga mbrojtësi.....	31
XVIII.	Evidentimi i kohës	32
XIX.	Dosjet gjyqësore përfundimtare	33
XX.	Sistemi elektronik <i>Legal Workflow</i>	33

I. KARAKTERI PUBLIK I PROCESIT GJYQËSOR

1. Në përputhje me nenin 40(4) të Ligjit,¹ Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”), Mbrojtja, dhe Mbrojtësi i Viktimave (“palët dhe pjesëmarrësit”) respektojnë karakterin publik të procesit gjyqësor. Palët dhe pjesëmarrësit parashtrojnë argumente juridike dhe paraqesin prova në seanca të mbyllura ose private vetëm në qoftë se kjo është rreptësisht e domosdoshme në pajtim me rregullën 120 të Rregullores.²
2. Palët dhe pjesëmarrësit përpiqen të dorëzojnë të gjitha parashtrimet me shkrim si dokumente publike, dhe t’i kufizojnë aspektet konfidenciale, sa më shumë që të jetë e mundur, në shtojca konfidenciale ose rreptësisht konfidenciale.
3. Kur një palë dorëzon mocion konfidencial ose rreptësisht konfidencial, prezumohet të ketë arsye të vlefshme për këtë status, derisa të vërtetohet e kundërta, dhe në përputhje me rregullën 82(4), pala tjetër duhet të respektojë këtë status, deri në një vendim të Trupit Gjyqësor që ndryshon statusin. Palët dhe pjesëmarrësit dorëzojnë pa vonesë, kurdoherë që është e mundshme, versionet publike të redaktuara të parashtrimeve të dorëzuara mbi bazë konfidenciale ose rreptësisht konfidenciale.
4. Palët dhe pjesëmarrësit udhëzohen të dorëzojnë sa më pak parashtrime ose shtojca *ex parte*. Trupi Gjyqësor do t’i shqyrtojë me imtësi arsyet e paraqitura për justifikim të parashtrimeve *ex parte*. Palët dhe pjesëmarrësit mund t’u referohen aspekteve konfidenciale gjatë seancave të hapura dhe në parashtrime publike me shkrim, por në një mënyrë që nuk zhvlerëson qëllimin e klasifikimit konfidencial.

¹ Çdo referim në “nen” në këtë urdhër nënkupton dispozitat e Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

² Çdo referim në “rregull” në këtë urdhër nënkupton dispozitat në Rregulloren e Procedurës dhe të Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

II. DREJTËSIA DHE SHPEJTËSIA E PROCESIT GJYQËSOR

5. Si Trupi Gjykses, ashtu dhe palët dhe pjesëmarrësit, kanë përgjegjësinë për garantimin e gjykimit të drejtë dhe të shpejtë. Trupi Gjykses nuk do të tolerojë nga asnjëra palë asnjë taktikë që vonon procesin. Gjatë gjithë kohës, ai do të synojë të garantojë ecurinë në kohë dhe në mënyrë efektive të procesit gjyqësor. Trupi Gjykses pret që palët dhe pjesëmarrësit, në kuadër të përgjegjësisive të tyre, t'i kontribuojnë këtij qëllimi në një mënyrë që përputhet me të drejtat e të akuzuarve dhe të viktimave pjesëmarrëse në proces.

6. Parashtrimet e palëve dhe të pjesëmarrësve, me gojë apo me shkrim, janë të përqendruara dhe të shkurtra. Palët dhe pjesëmarrësit shmangin fjalime të gjata, përsëritje të parashtrimeve ose parashtrime për aspekte që nuk lidhen me procesin gjyqësor.

7. Palët dhe pjesëmarrësit nuk ngrenë në sallë të gjyqit aspekte që vonojnë panevojshëm rrjedhën e procesit gjyqësor, përveç nëse ai aspekt ndikon drejtpërdrejt në një dëshmitar i cili është në prag të dhënies së dëshmisë, ose për arsye të tjera të përligjura. Përpara ngritjes së këtyre aspekteve, pala ose pjesëmarrësi njoftojnë me shkrim ose me gojë Trupin Gjykses dhe palën dhe pjesëmarrësit e tjerë lidhur me synimin, me hollësi të mjaftueshme lidhur me llojin dhe bazën e kërkesës. Pala tjetër, dhe kur është e përshtatshme Mbrojtësi i Viktimave, u parashtrojnë Trupit Gjykses dhe palës dhe pjesëmarrësve të tjerë, pa vonesë me shkrim ose me gojë qëndrimin e tyre lidhur me kërkesën e propozuar dhe në veçanti, nëse e kundërshtojnë dhe nëse, po, bazën e kundërshtimit. Trupi Gjykses vendos nëse nevojiten parashtrime shtesë dhe i udhëzon palët dhe pjesëmarrësit lidhur me to. Në përgjithësi pritet që palët dhe pjesëmarrësit të diskutojnë mes tyre për të gjetur zgjidhje të pranueshme lidhur me aspekte që dalin gjatë gjykimit, dhe t'i drejtohen Trupit Gjykses vetëm kur kjo gjë nuk është e mundur.

8. Në përputhje me rregullën 17, në këshillim me gjykatësit e Trupit Gjykses, Kryegjykatësi mund të caktojë një gjykatës raportues për të trajtuar aspektet konkrete që lidhen me garantimin e procesit të drejtë dhe të shpejtë.

III. GJUHA E PUNËS

9. Trupi Gjykses miraton qëndrimin e Gjykatësit të Vetëm në lidhje me gjuhën e punës gjatë procesit gjyqësor, sikurse përcaktohet në Vendimin mbi Gjuhën e Punës, i datës 11 nëntor 2020³ dhe vendos se anglishtja është gjuha e punës gjatë seancave të gjykimit në procesin aktual dhe se palët dhe pjesëmarrësit duhet të vazhdojnë t'i respektojnë udhëzimet e këtij Vendimi.⁴

IV. SJELLJA NDAJ TRUPIT GJYKUES DHE PALËVE E PJESËMARRËSVE

10. Në pajtim me nenin 10 të Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Kodi i Etikës"), mbrojtësit dhe prokurorët kanë obligim të përgjithshëm të jenë të sinqertë ndaj Trupit Gjykses.

11. Palët dhe pjesëmarrësit tregojnë respekt ndaj njëri-tjetrit gjatë gjithë kohës, si në sallë të gjyqit ashtu edhe jashtë saj. Trupi Gjykses nuk toleron komente dhe kritika personale drejtuar ndonjëres prej palëve ose pjesëmarrësve. Palët dhe pjesëmarrësit nuk përdorin taktika dredharake dhe çdo herë që është e mundur, informojnë paraprakisht palët dhe pjesëmarrësit e tjerë lidhur me parashtrime me shkrim ose me gojë që synojnë t'ia paraqesin gjykatës.

12. Trupi Gjykses pret që palët dhe pjesëmarrësit të diskutojnë mes vete rregullisht për aspekte që dalin nga procesi gjyqësor me qëllim gjetjen e zgjidhjeve që nuk kërkojnë ballafaqime gjyqësore ose t'i pakësojnë ato.

³ F00072, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Gjuhën e Punës*, 11 nëntor 2020.

⁴ Transkripti i seancës, 16 dhjetor 2022, f. 1772, rreshtat 3-8.

13. Komunikimet me gjykatësit rregullohen me nenin 11 të Kodit të Etikës. Palës kundërshtare i bëhen të ditura ose i njoftohen komunikimet e palës ose të një pjesëmarrësi tjetër me Trupin Gjykes.

14. Në përputhje me Kodin e Etikës, çdo problem që një palë ose pjesëmarrës ka me palën ose pjesëmarrësin tjetër, ose me mbrojtësin që vepron në emër të një pale ose pjesëmarrësi, i bëhet i ditur së pari palës ose mbrojtësit përkatës. Nëse mospajtimi nuk mund të zgjidhet, ai u bëhet i ditur autoriteteve të përcaktuara në Kodin e Etikës ose Trupit Gjykes.

V. KONTAKTI ME MEDIAT

15. Publiku është i interesuar të jetë i informuar lidhur me rrjedhën e procesit gjyqësor. Në të njëjtën kohë, respektohen të drejtat e të gjithë të përfshirëve – në veçanti të akuzuarve dhe viktimave – përfshirë në kontekst të diskutimeve lidhur me këtë proces gjyqësor. Trupi Gjykes mban parasysh nevojën për ruajtjen dhe mbrojtjen e prezumimit të pafajësisë së të akuzuarve si dhe sigurinë dhe reputacionin e dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm. Për të gjetur balancën midis këtyre interesave, është me rëndësi thelbësore që informacioni, i cili nxirret publikisht nga cilado palë ose pjesëmarrës tjetër, të jetë i saktë. Është gjithashtu me rëndësi thelbësore që informacioni jopublik ose konfidencial të mos nxirret publikisht, drejtpërdrejt ose tërthorazi. Mbrojtësit e palëve dhe pjesëmarrësve duhet të sigurohen se të gjithë ata që veprojnë nën autoritetin e tyre, përfshirë hetues, praktikantë dhe punonjës të tjerë, njihen me detyrimet e tyre në këtë aspekt dhe përgjegjësinë penale të tyre të mundshme lidhur me nxjerrjen e informacionit konfidencial.

16. Trupi Gjykes u tërheq vëmendjen mbrojtësve lidhur me nenin 13 të Kodit të Etikës, i cili rregullon komunikimet në mediat sociale, në shtyp dhe publik.

17. Trupi Gjykses gjykon se deklarata të 'rreme' ose 'shpifëse', sipas nenit 13(a) të Kodit të Etikës, përfshijnë deklarata të cilat janë me qëllim ose me vetëdije, çorientuese.
18. Mbrojtësit nuk komentojnë publikisht lidhur me kërkesat nën shqyrtim nga Trupi Gjykses, derisa Trupi Gjykses të marrë vendim. Trupi Gjykses pret nga palët dhe pjesëmarrësit që të debatojnë vetëm para Trupit Gjykses çfarëdo aspekti që lidhet me procesin gjyqësor dhe që i parashtrohet atij për vendim.
19. Çdo koment në media nga mbrojtësit lidhur me vendime ose urdhra të Trupit Gjykses bëhet në përputhje me detyrimin e sinqeritetit, zellit, dinjitetit dhe integritetit.
20. Mbrojtësit janë përgjegjës për veprimet dhe deklarimet, përfshirë deklarimet në media, të personave që veprojnë nën autoritetin mbikëqyrës të tyre të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë.

VI. NXJERRJA E MATERIALIT

21. Sistemi me tri faza për nxjerrje të materialit sipas rregullës 102(3) i zbatueshëm në DHSK, është përcaktuar nga ky Grup Gjykses në çështjen gjyqësore *Gucati dhe Haradinaj*.⁵ Trupi Gjykses do ta zbatojë këtë standard në çështjen gjyqësore aktuale dhe urdhëron palët dhe pjesëmarrësit ta zbatojnë atë rreptësisht dhe ndershmërisht.

⁵ KSC-BC-2020-07, F00304, Trupi Gjykses II, *Urdhër në lidhje me Njoftimin e Hollësishëm të Përditësuar sipas Rregullës 102(3)*, 7 shtator 2021, me shtojcën konfidenciale dhe *ex parte*, para. 16, 20; F00413, Trupi Gjykses II, *Vendim mbi Kundërshtimet e Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialeve në Njoftimin e Përditësuar të Rregullës 102(3)*, 3 nëntor 2021, me shtojcën rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, para. 36; F00435, Trupi Gjykses II, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë në lidhje me Materialin 201 në Njoftimin sipas Rregullës 103(2)*, 15 nëntor 2021, konfidencial, para. 11; F00479, Trupi Gjykses II, *Vendim mbi Nxjerrjen e Materialit 202*, 7 dhjetor 2021, konfidencial, para. 11; F00533, Trupi Gjykses II, *Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së në lidhje me Materiale 203 dhe 204*, 25 janar 2022, konfidencial, para. 14; F00541, Trupi Gjykses II, *Vendim mbi Kërkesat e ZPS-së në lidhje me Materialin 205*, 28 janar 2022, konfidencial, para. 12. *Shih gjithashtu KSC-BC-2020-07, IA005-F00008, Paneli i Gjykatës së Apelit, Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelet Kundër Vendimit për Nxjerrje të Informacionit*, 29 korrik 2021, para. 39; F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit për Rëndësinë Materiale të Informacionit të Kërkuar në përputhje me Rregullën 102(3) dhe Çështje të lidhura me Të*, 1 prill 2021, para. 22.

22. ZPS-ja ka detyrim të vazhdueshëm të nxjerrë pa vonesë çdo material që posedon, i cili duhet të nxirret sipas rregullës 102(3) ose rregullës 103. Megjithatë, ZPS-ja përpiket të nxjerrë të gjithë këtë material para fillimit të gjykimit. Pasi të ketë marrë dosjet paraprake të Mbrojtjes, ZPS-ja ndërmeret pa vonesë të gjithë hapat e domosdoshëm për nxjerrje të materialit shtesë që është objekt i nxjerrjes, në bazë të informacionit që ka marrë për llojin e argumenteve mbrojtëse të paraqitura nga secili prej ekipeve të Mbrojtjes. ZPS-ja i kushton vëmendje të veçantë nxjerrjes në kohë të materialit shfajësues shtesë, në veçanti materialit që mund të ndikojë negativisht në besueshmërinë e ndonjërit prej dëshmitarëve të vetë.

23. Në përputhje me rregullën 102(4), me kërkesë të Trupi Gjykses, ZPS-ja duhet të jetë e gatshme të japë arsyetimin për nxjerrje të materialit me vonesë.

24. Nëse pas fillimit të gjykimit, ZPS-ja merr në posedim material të ri që duhet nxjerrë sipas rregullës 102(3) ose rregullës 103, ajo e nxjerr menjëherë materialin dhe njofton Trupin Gjykses lidhur me nxjerrjen, së bashku me një përshkrim të shkurtër të përmbajtjes së secilit dokument të nxjerrë të ri.

25. Kërkesat për nxjerrje nuk duhet të trajtohen si “ekspeditë peshkimi”. Kur Mbrojtja kërkon nxjerrje të materialit, ajo përshkruan në hollësi të mjaftueshme materialin të cilin kërkon, për t’i mundësuar ZPS-së identifikimin pa vonesë të materialit të kërkuar. Kërkesat duhet të jenë gjithashtu mjaftueshëm të qarta në mënyrë që ZPS-ja të mund të kundërshtojë kategoritë që kërkohen.

VII. REDAKTIMET

26. Në varësi të ndryshimeve që urdhëron Trupi Gjykses, ai do të ndjekë sistemin e redaktimit të përcaktuar në Vendimin Kornizë të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Nxjerrjen e Provave dhe të Materialit lidhur me To, i datës 23 nëntor 2020 (“Vendimi Kornizë”).⁶ Trupi Gjykses pret që palët dhe pjesëmarrësit të përmbushin

⁶ F00099, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje Lidhur me Të*, 23 nëntor 2020.

përgjegjësit e tyre lidhur me redaktime në kohë, me ndershmëri dhe në përputhje me parimin e gjykimit publik dhe të drejtat e të akuzuarve.

27. Paraprakisht, Trupi Gjykses vë në dukje se pala që kërkon redaktimet ka detyrimin për të vërtetuar domosdoshmërinë dhe arsyetimin.

28. Trupi Gjykses thekson se:

- Pala ose pjesëmarrësi që ka zbatuar redaktimet në dokumente të nxjerra për pjesëmarrësit e tjerë në përputhje me Vendimin Kornizë, ka detyrim të përhershëm të monitorojë nevojën e mbajtjes së mëtejshme të të gjitha redaktimeve dhe të nxjerrë sërish, pa kërkuar leje, version me më pak redaktime të secilit dokument, sapo të pushojnë së ekzistuari arsyet që i përlligjin ato.
- Pala marrëse ose pjesëmarrësi marrës mund të kundërshtojë çfarëdo redaktimi konkret për të cilin mendon se është i papërligjur, dëmton ushtrimin efektiv të drejtave të veta, ose nëse mendon se një redaktim konkret duhet të hiqet si rezultat i rrethanave të ndryshuara. Për këtë qëllim ajo i drejtohet palës nxjerrëse drejtpërdrejt, sapo të krijohen rrethanat që përlligjin heqjen e redaktimeve. Palët konsultohen në mirëbesim për të sqaruar çështjen.
- Nëse palët nuk janë në gjendje të pajtohen, pala marrëse mund t'i bëjë kërkesë Trupit Gjykses pa vonesë për mjet juridik të duhur. Trupi Gjykses mundet gjithashtu, *proprio motu*, të kryejë hetimin e vet lidhur me këto aspekte për të garantuar drejtësinë dhe shpejtësinë e procesit.

29. Trupi Gjykses thekson se redaktimet në dokumente dhe në deklarata të paraqitura në prova duhet të bëhen vetëm kur janë absolutisht të domosdoshme për mbrojtjen e interesit legjitim dhe janë proporcionale me objektivin që synojnë të arrijnë, duke mbajtur parasysh të drejtat e të akuzuarve dhe parimin e gjykimit publik. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses udhëzon palën që paraqet materialin të rishikojë

redaktimet ekzistuese dhe të vendosë nëse ato vazhdojnë të jenë absolutisht të domosdoshme.⁷

30. ZPS-ja ka detyrim të përhershëm të vlerësojë vazhdimisht domosdoshmërinë e të gjitha redaktimeve në dokumentet e nxjerra sipas rregullës 102(3) dhe/ose rregullës 103. Në veçanti, ZPS-ja siguron që redaktimet në një material që do të paraqitet si provë gjatë gjykimit, të jenë vetëm redaktime absolutisht të domosdoshme.

31. ZPS-ja mban diskutime me Mbrojtjen dhe Mbrojtësin e Viktimave me qëllim identifikimin e pikave të mundshme të pajtueshme dhe pikave që përbëjnë shqetësim në lidhje me redaktime që ajo synon të mos heqë.

VIII. PJESËMARRJA E VIKTIMAVE

32. Pjesëmarrja e viktimave duhet të jetë efektive, në kuptimin që garanton se Mbrojtësi i Viktimave jep kontribut të njëmendtë në procesi gjyqësor, pa dubluar ose ndërhyrë në përgjegjësitë e ZPS-së ose të Mbrojtjes.

33. Pasi të ketë marrë datat e dëshmimeve të dëshmitarëve që do të thirren nga ZPS-ja ose Mbrojtja, Mbrojtësi i Viktimave njofton Trupin Gjyqësor dhe palët dhe pjesëmarrësit e tjerë për dëshmitarët që dëshirojnë të marrë në pyetje, duke dhënë një përshkrim të përgjithshëm lidhur me pikat ose aspektet për të cilat dëshirojnë të pyesë secilin dëshmitar, përfshirë një shpjegim të shkurtër se si ndikon dëshmia që pritet të jepet në interesat e tyre personale.

34. Marrja në pyetje e dëshmitarëve nga Mbrojtësi i Viktimave përqendrohet parimisht në: (i) dëmin ose lëndimin që u është shkaktuar viktimave dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur; (ii) pasojat e këtyre veprimeve mbi viktimën, të afërmit e ngushtë ose mbi komunitetin të cilit i përket ai apo ajo; dhe (iii) mjetin juridik të përshtatshëm për kompensimin e dëmit shkaktuar viktimës.

⁷ Për udhëzim të përgjithshëm, shih KSC-BC-2020-07, F00503, Trupi Gjyqësor II, *Vendim mbi Redaktimet e Propozuara të Disa Provable Materiale të Pranuarë*, 17 dhjetor 2021, para. 13-18.

35. Nëse Mbrojtësi i Viktimave dëshiron të bëjë pyetje në lidhje me ndonjë temë tjetër, ai duhet t'i kërkojë lejë Trupit Gjykses, shoqëruar me; (ii) një arsyetim për kërkesën; dhe (iii) një llogaritje të kohës së nevojshme për pyetje shitesë.

36. Në varësi të miratimit paraprak nga Trupi Gjykses, Mbrojtësit të Viktimave i lejohet të paraqesë prova dhe të udhëzojë ekspertë, vetëm në lidhje me aspektet (i)-(iii) të përmendura në paragrafin 34.

IX. PIKAT E PAKUNDËRSHTUARA DHE KOMUNIKIMET MIDIS PALËVE

37. Sikurse u theksua më lart, Trupi Gjykses dhe palët e pjesëmarrësit kanë përgjegjësinë e garantimit të gjykimit të drejtë dhe të shpejtë. Për të kontribuar në këtë qëllim të përbashkët, palët dhe pjesëmarrësit duhet të sigurojnë që procesi gjyqësor të përqendrohet në ato aspekte për të cilat me të vërtetë ka mospajtime midis tyre.

38. Rrjedhimisht, në përputhje me rregullën 95(4)(a),⁸ Trupi Gjykses fton palët dhe pjesëmarrësit të zhvillojnë diskutime me njëri-tjetrin për të identifikuar nëse ka mospajtime në lidhje me aspektet e mëposhtme të provave të ZPS-së dhe nëse po, llojin dhe shkallën e mospajtimimit:

- a. Krimet e pretenduara bazë;
- b. Ekzistenca, kuadri kohor dhe lloji i konfliktit të armatosur të pretenduar;
- c. Ekzistenca dhe kuadri kohor i kriterit të përgjithshëm të pretenduar për krime kundër njerëzimit;
- d. Historiku dhe të dhënat personale të të akuzuarve, sikurse përcaktohet në paragrafët 1-12 të Aktakuzës; dhe
- e. Lidhja me lëndën dhe pranueshmëria e provave materiale të propozuara të ZPS-së.

⁸ Rregulla 95(4)(a) kërkon që Dosja Paraprake të ZPS-së të përfshijë çfarëdo pranimi në lidhje me faktet nga ana e Mbrojtjes, përfshirë listën e pikave të pakontestuar.

39. Palët dhe pjesëmarrësit udhëzohen gjithashtu të zhvillojnë diskutime me njëri-tjetrin për identifikimin e dëshmitarëve, dëshmitë e të cilëve, me marrëveshje, mund të paraqiten në bazë të rregullave 153, 154 ose 155. Kur pajtohen për pranimin e dëshmisë së një dëshmitari sipas rregullës 153, palët dhe pjesëmarrësit këshillohen të arrijnë një marrëveshje nëse dëshirojnë që Trupi Gjykses të kërkojë paraqitjen e dëshmitarit për marrje në pyetje nga pala tjetër.

40. Palët dhe pjesëmarrësit udhëzohen t'i raportojnë Trupit Gjykses lidhur me diskutime, ku të tregojnë: (i) pikat e pajtimit (ose të mospajtimit) lidhur me ndonjërin prej këtyre aspekteve; dhe (ii) nëse ka mospajtim, bazën dhe llojin e mospajtimit.

41. Në përputhje me rregullën 156, Trupi Gjykses përgjithësisht nuk kërkon pranimin si prova të fakteve dhe pikave për të cilat nuk ka mospajtim midis palëve dhe pjesëmarrësve, por mund të mbajë shënim pikat e pajtimit midis palëve dhe pjesëmarrësve. Megjithatë, në qoftë se një palë vendos të paraqesë prova lidhur me një fakt për të cilin palët pajtohen, ajo palë duhet ta bëjë këtë në mënyrë efikase.

42. Trupi Gjykses lejon pyetje mbi aspekte për të cilat nuk ka mospajtim midis palëve dhe pjesëmarrësve vetëm në rrethana të posaçme dhe pasi i tregohen arsye të vlefshme.

43. Përgjithësisht, prej palëve dhe pjesëmarrësve pritët që të zgjidhin midis tyre mospajtimet që lindin, përpara se të kërkojnë ndihmën e Trupit Gjykses. Nëse për palët dhe pjesëmarrësit bëhet e pamundur të zgjidhin mospajtimet, pala dhe pjesëmarrësi që dëshiron të ngrejë mospajtimin para Trupit Gjykses, e njofton atë së paku 24 orë para seancës gjatë së cilës dëshiron të diskutojë mospajtimin. Pala ose pjesëmarrësi e informon Trupin Gjykses shkurtimisht lidhur me: (i) mospajtimin në fjalë; (ii) gjendjen e diskutimeve të palëve dhe pjesëmarrësve; dhe (iii) mjetin juridik të kërkuar dhe bazën ligjore mbi të cilën kërkohet.

X. NJOFTIMI PËR ARGUMENTET MBROJTËSE

44. Në përputhje me rregullën 95(5), Mbrojtja i ka dhënë ZPS-së njoftimin për synimin për paraqitjen e argumenteve mbrojtëse ose arsyeve që përjashtojnë përgjegjësi penale të përmendura në atë dispozitë.⁹ Trupi Gjykes do të caktojë afatin për Mbrojtjen për dorëzimin e versioneve të ndryshuara të njoftimeve për alibi kur të hiqen redaktimet në Aktakuzë.

45. Nëse Mbrojtja synon të paraqesë argumente mbrojtëse që nuk përcaktohen shprehimisht në rregullën 95(5), dhe nëse këto argumente mbrojtëse nuk janë shtjelluar në Dosjet Paraprake të Mbrojtjes, ajo njofton ZPS-në, Mbrojtësin e Viktimave dhe Trupin Gjykes lidhur me argumentet mbrojtëse, jo më vonë se 20 shkurt 2023. Në njoftim përfshihen: (i) përshkrimi i përgjithshëm i argumenteve mbrojtëse; (ii) të dhëna për bazën ligjore në të cilën mbështeten këto argumente; dhe (ii) mjete juridik që kërkohet.

XI. AUTENTICITETI I PROVAVE TË PROPOZUARA DHE MBËSHTETSHMËRIA NË TO

46. Në pajtim me rregullën 138(1), një palë nuk kërkon të parashtrojë ose paraqesë prova për të cilat e di ose dyshon se janë të rreme. Trupi Gjykes pret nga pala që paraqet provat të ketë ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të siguruar se logjikisht mund të mbështetesh në provat e paraqitura para Trupit Gjykes për qëllimin për të cilin paraqiten. Është përgjegjësi e palës që, nëse kërkohet prej Trupit Gjykes, të mund t'i japë informacion Trupit Gjykes në lidhje me burimin e provës materiale dhe hapat e ndërmarrë për verifikimin se logjikisht mund të mbështetesh në informacionin në fjalë.

⁹ F01065, Mbrojtësi i Specializuar, *Njoftim për Alibi i Mbrojtjes së Thaçit*, 28 tetor 2022, para. 2, 5-6; F01066, Mbrojtësi i Specializuar, *Njoftim për Alibi i Mbrojtjes së Veselit*, 28 tetor 2022, para. 4; F01067, Mbrojtësi i Specializuar, *Njoftim për Alibi i Mbrojtjes së Selimit*, 28 tetor 2022, para. 3-5. *Shih gjithashtu* F01051, Mbrojtësi i Specializuar, *Dosja Paraprake e Jakup Krasniqit*, 21 tetor 2022, konfidencial, para. 19, 79; F01052/COR, Mbrojtësi i Specializuar, *Version i Korrigjuar i Dosjes Paraprake në Emër të Kadri Veselit*, 25 tetor 2022, me Shtojcat 1-3, konfidencial, para. 40, 41, 48, 52, 118.

47. Pala që kundërshton një provë materiale e bën të qartë kundërshtimin para ose në kohën e paraqitjes së provës për pranim.

XII. PARAQITJA DHE PRANIMI I PROVAVE

48. Në listën e dëshmitarëve dhe provave të propozuara, pala përfshin vetëm dëshmitarë që synon të thërrasë dhe prova për të cilat ka synim të njëmendtë t'i paraqesë gjatë gjykimit. Në momentin që vendos të mos thërrasë një dëshmitar ose të mos paraqesë një provë materiale të përmendur në listë, pala në fjalë ua bën këtë të ditur palës dhe pjesëmarrësve të tjerë. Çdo kërkesë për ndryshim të listave bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe përveçse në rrethana të posaçme, në kohë të mjaftueshme para fillimit të paraqitjes së provave të asaj pale.

49. Trupi Gjykues këshillon palët dhe pjesëmarrësit të përdorin një standard të lartë gjatë vlerësimit të provave që paraqiten për pranim, për të siguruar paraqitjen vetëm të provave me vlerë të lartë provuese. I takon palës që paraqet një material të provojë lidhjen me lëndën dhe vlerën provuese të provës materiale, dhe lidhjen e provës me dëshminë e dëshmitarit, përmes të cilit pala kërkon të paraqesë provën materiale. Palët dhe pjesëmarrësit duhet të kërkojnë të paraqesin prova materiale vetëm përmes dëshmitarit me dëshminë e të cilit ato lidhen qartësisht.

50. Sa u përket dokumenteve të gjata ose librave, ku vetëm një pjesë ka lidhje me lëndën ose ku pala mbështetet vetëm në një pjesë, pala që paraqet materialin bën të ditur, në gjuhën origjinale dhe në anglishte, faqet e dokumentit që kërkon të pranohen si prova. Nëse i gjithë dokumenti paraqitet si provë, pala tenton po ashtu të identifikojë, për aq sa është e mundur, pjesët e dokumentit në të cilin kërkon të mbështesë argumentet e saj.

51. Trupi Gjykues këshillon fuqimisht palët dhe pjesëmarrësit të përdorin në mënyrë efektive rregullat 153, 154 dhe 155, për aq sa është e mundur, me qellim

përshejtimin e procesit gjyqësor. Palët dhe pjesëmarrësit i dorëzojnë kërkesat sipas rregullave 153-155, jo më vonë se afati i përcaktuar në paragrafin 73 më poshtë.

52. Në rrethana të përshtatshme (si p.sh., në lidhje me autenticitetin, përkthimin ose nxjerrjen e materialeve), prova materiale që parashtrahet gjatë gjykimit mund të shënohet për identifikim ("MFI") në pritje të marrjes së informacionit të mëtejshëm. Prova të propozuara të tilla nuk do të pranohen deri në marrjen e vendimit, me gojë ose me shkrim, prej Trupit Gjyqësor për pranimin e tyre, kur edhe u caktohet numri zyrtar i provës materiale.

53. Dokumentet e papërkthyer që përdoren gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit ose mund të shënohen për identifikim në pritje të përkthimit dhe të urdhrimit të mëtejshëm të Trupit Gjyqësor, ose të mos pranohen.

54. Administratorja ose Kryegjykatësi/Kryegjykatësja caktojnë numrin e provës materiale kur pranohen.

55. Palët dhe pjesëmarrësit sigurojnë që në sallë të gjyqit dhe në parashtrime me shkrim, t'u referohen, me numër të provës materiale ose me numër MFI, dokumenteve të pranuar si prova ose dokumenteve të shënuara për identifikim.

56. Nëse një palë përdor version ose përkthim të dokumentit të pranuar tashmë si provë, ose të shënuar për identifikim, ajo ia bën të qartë këtë Trupit Gjyqësor përpara se të përdorë version tjetër. Ajo gjithashtu i referohet dokumentit të pranuar, me të cilin lidhet versioni tjetër, me numër të provës materiale ose MFI.

XIII. MOSPAJTIMET LIDHUR ME PËRKTHIMIN ME SHKRIM DHE/OSE ME GOJË

57. Palët dhe pjesëmarrësit vënë në dispozicion për përkthyesit me gojë të gjykatës kopje të deklaratave të tyre hyrëse dhe përmbyllëse, për aq sa të jetë e mundur, me qëllim mundësimin e përkthimit të saktë dhe efikas në sallë të gjyqit.

58. Sapo një palë ose pjesëmarrës të ketë marrë një dokument të cilin pala tjetër synon ta përdorë si provë, pala marrëse verifikon saktësinë dhe plotësinë e dokumentit. Pala marrëse i paraqet pa vonesë Zyrës Administrative problemet që ka me përkthimin. Nëse problemi nuk mund të zgjidhet me ndihmën e Zyrës Administrative, pala marrëse njofton Trupin Gjyqësor në kohë.

59. Prej palëve dhe pjesëmarrësve pritet të paraqesin pa vonesë çdo problem lidhur me përkthimin ose saktësinë e transkriptit ose të procesverbalit të seancave gjyqësore. Ky problem i paraqitet së pari Zyrës Administrative, dhe kur nuk mund të zgjidhet, Trupit Gjyqësor.

XIV. MOCIONET PËR PROVA JOGOJORE

60. Palët dhe pjesëmarrësit duhet të marrin parasysh parashtrimin e provave përmes mocioneve për prova jогоjore, me qëllim garantimin e shpejtësisë së procesit gjyqësor.

61. Para se të dorëzojë mocion për prova jогоjore, pala u jep palës dhe pjesëmarrësve të tjerë listën e provave që propozon të parashtrijë. Ajo kërkon nga pala dhe pjesëmarrësit e tjerë t'i bëjnë të ditur nëse kanë kundërshtim ndaj pranimin të disa prej provave materiale ose të gjitha provave materiale.

62. Pala që kërkon pranimin e provave jогоjore:

- i. jep përshkrim të shkurtër të provës materiale të propozuar për të cilën kërkon pranimin;
- ii. specifikon qartë lidhjen e provës materiale të propozuar me lëndën duke iu referuar paragrafit (paragrafëve) përkatës në Aktakuzë dhe vlerën provuese të secilës prej provave materiale të propozuara; dhe
- iii. jep tregues të autenticitetit të provës materiale të propozuar, kur dokumenti nuk përmban tregues të autenticitetit në pamje të parë.

XV. DËSHMITARËT

A. MASAT MBROJTËSE

63. Nëse palët dhe Mbrojtësi i Viktimave nuk janë urdhëruar tashmë, ata udhëzohen të dorëzojnë kërkesa për masa mbrojtëse në përputhje me rregullat 80-81 sa më herët që të jetë e mundur, dhe gjithsesi mjaftueshëm në kohë për t'u mundësuar palëve dhe pjesëmarrësve paraqitjen e përgjigjeve të njëmendta.

64. Kërkesat për ndryshimin e masave mbrojtëse specifikojnë qartë masat mbrojtëse që kërkohen, dhe tregojnë me saktësi rrethanat që arsyetojnë objektivisht miratimin e masave mbrojtëse.

65. Kur dëshmitari informon palën thirrëse se nuk i nevojiten më masat mbrojtëse, pala thirrëse njofton në kohë Zyrën për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve ("ZMMD") dhe Trupin Gjykses dhe mundëson përmbushjen e kriterit të heqjes dorë prej masave sipas kriterëve të rregullës 81(6).

66. Masat mbrojtëse miratohen vetëm kur ato përlicjen mbi bazë objektive për dëshmitarin në fjalë. Detyrimi për të vërtetuar ekzistencën e asaj baze i takon palës që kërkon masat mbrojtëse. Palës në fjalë i takon që të sigurojë prova, deklarata dhe informacion përkatës për të mbështetur kërkesën e vet.

67. Kërkesat për masa mbrojtëse parashtrohen në kohë dhe sa më shpejt që të jetë e realizueshme. Palët dhe pjesëmarrësit duhet, ndër të tjera, të: a) shqyrtojnë rregullisht nëse masat e miratuara janë ende të domosdoshme; dhe b) kontaktojnë secilin prej dëshmitarëve të tyre sa më shpejt që të jetë e realizueshme, përpara se të fillojnë të japin dëshmi për të verifikuar nëse ata dëshirojnë të kenë masa mbrojtëse ose të ruajnë të miratuarat dhe informojnë Trupin Gjykses dhe pjesëmarrësit e tjerë lidhur me to.

68. Trupi Gjykses kujton palët dhe pjesëmarrësit se procesi gjyqësor prezumohet të jetë publik dhe nuk do të miratojë masa mbrojtëse bazuar në pandehma ose

pretendime të përgjithshme që nuk kanë të bëjnë konkretisht me dëshmitarin në fjalë ose të cilat nuk janë vërtetuar mjaftueshëm.¹⁰

69. Në raste kur Zyra Administrative synon të bëjë parashtrime në lidhje me masa mbrojtëse, ajo e bën këtë menjëherë pas paraqitjes së kërkesës për masa mbrojtëse nga pala ose pjesëmarrësit në proces dhe përpara vendimit të Trupit Gjykses në lidhje me atë kërkesë.¹¹

70. Palët dhe pjesëmarrësit ftohen të zhvillojnë në diskutime midis tyre me qëllim identifikimin e masave mbrojtëse për të cilat nuk ka kundërshtime. Të gjitha palët dhe pjesëmarrësit udhëhiqen prej nevojës për balancë midis respektimit të sigurisë së dëshmitarëve, parimit të procesit publik dhe të drejtave të të akuzuarve.

B. INTERVISTA ME DËSHMITARË TË PALËS KUNDËRSHTARE

71. Sa u përket procedurës dhe garancive të zbatueshme për kontaktin me dëshmitarët e palës ose pjesëmarrësve kundërshtarë, palët dhe pjesëmarrësit i përmbahen Vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit të 27 dhjetorit 2022.¹² Kur një palë ose pjesëmarrës gjykon se që nga Vendimi i Panelit të Gjykatës së Apelit ka ndryshim material të rrethanave që ndikon në bazën e vendimit, pala ose pjesëmarrësi mund të kërkojë nga Trupi Gjykses mjet juridik të përshtatshëm.

¹⁰ Shih KSC-BC-2020-07, F00303, Trupi Gjykses II, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Masa Mbrojtëse*, 7 shtator 2021, para. 15; F00373, Trupi Gjykses II, *Vendim mbi Kërkesën e ZMMD-së për Masa Mbrojtëse*, 15 tetor 2021, para. 24. Shih gjithashtu Transkriptin e seancës, 5 nëntor 2021, f. 1926.

¹¹ Shih KSC-BC-2020-07, F00373, Trupi Gjykses II, *Vendim mbi Kërkesën e ZMMD-së për Masa Mbrojtëse*, 15 tetor 2021, para. 19, 28(b).

¹² IA024/F00019, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim në lidhje me Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar* ("Vendimi i Panelit të Gjykatës së Apelit"), 27 dhjetor 2022.

C. PLANIFIKIMI I DËSHMITARËVE DHE I MATERIALIT QË DO TË PËRDORËT GJATË MARRJES NË PYETJE

72. Pala paraqitëse udhëzohet të paraqesë provat e saj në mënyrë logjike dhe të njoftojë Trupin Gjyqësor lidhur me rendin që do të ndjekë për t'i paraqitur ato. Kur më shumë se një ekip i Mbrojtës synon të thërrasë të njëjtin dëshmitar, mbrojtësit këshillohen me njëri-tjetrin lidhur me llojin dhe kuadrin e provave të tyre dhe përpiqen të shmangin përsëritjet në paraqitjen e argumenteve të tyre përkatëse.

73. Trupin Gjyqësor vë në dukje se ZPS-ja parashtrori listën paraprake të dyzet dëshmitarëve të parë që do të thirren në gjykim.¹³ Trupin Gjyqësor kërkon gjithashtu që, një muaj para përfundimit të dëshmive të këtyre dëshmitarëve, ZPS-ja t'u dorëzojë Trupit Gjyqësor dhe palës e pjesëmarrësve të tjerë listën e dëshmitarëve që synon të thërrasë gjatë periudhës së ardhshme tremujore dhe të vazhdojë me këtë praktikë çdo tre muaj ose deri në një vendim të mëtejshëm prej Trupit Gjyqësor. Lista duhet të shoqërohet me mocion për prova jogojore, të cilin pala thirrëse synon të dorëzojë në përputhje me paragrafin 60 deri në 62 më lart, në lidhje me dokumentet që ZPS-ja synon të përdorë ose të paraqesë përmes cilitdo prej dëshmitarëve të thirrur gjatë periudhës tremujore ose që janë relevante për pjesë të provave të ZPS-së të përmendura nga këta dëshmitarë.

74. ZPS-ja i rendit dëshmitarët në renditje paraprake sipas të cilës do të thirren, duke i identifikuar nëse është nevojë sipas grupimit. Pas kësaj, ZPS-ja njofton Trupin Gjyqësor dhe palën e pjesëmarrësve në kohën e duhur për çdo ndryshim në renditjen e propozuar të paraqitjes së dëshmitarëve. Kjo përfshin:

- i. emrin dhe pseudonimin e dëshmitarit, në varësi të masave mbrojtëse;

¹³ F01117, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Listës Paraprake të 40 Dëshmitarëve të Parë që do të Thirren në Gjykim*, 18 nëntor 2022, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidencial dhe ex parte, dhe Shtojcën 2, konfidenciale.

- ii. të gjitha deklaratat transkriptet e mëparshme të dëshmimeve të dëshmitarit,¹⁴
- iii. nëse ZPS-ja propozon që dëshmitari duhet të dëshmojë pjesërisht ose tërësisht duke qenë i pranishëm, dhe nëse ZPS-ja synon të paraqesë deklaratën ose transkriptin e dëshmisë së dëshmitarit në pajtim me rregullën 154 ;
- iv. pikat, faktet dhe rrethanat në lidhje me të cilat do të merret në pyetje dëshmitari;
- v. kohëzgjatja e nevojshme që vlerësohet për pyetje nga pala thirrëse;
- vi. dokumentet dhe provat materiale që ZPS-ja propozon t'i përdorë me këtë dëshmitar, dhe numrin e provës materiale apo numrin identifikues MFI të të gjitha atyre që janë pranuar si prova apo që janë shënuar për identifikim; dhe
- vii. masat mbrojtëse të urdhëruara në lidhje me dëshmitarin (me referenca të urdhrave përkatës).

75. Në të njëjtën kohë, ZPS-ja dorëzon parashtrime lidhur me domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e masave mbrojtëse të urdhëruara në lidhje me dëshmitarin e propozuar që përfshijnë nxjerrje të vonuar të materialit provues në lidhje me dëshmitarët e propozuar. Për secilin prej dëshmitarëve të mbrojtur ekzistues, ZPS-ja përshkruan qartë faktet konkrete që përlligjin domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e masave mbrojtëse përkatëse në këtë fazë të procesit.

76. Mbrojtja dhe Mbrojtësi i Viktimave:

- i. brenda 5 ditësh pasi të kenë marrë listën, dorëzojnë kërkesën për ndryshimin e masave mbrojtëse lidhur me cilindo prej dëshmitarëve në listë, ku përcaktojnë qartë dhe konkretisht arsyet në mbështetje të kërkesës. Çdo përgjigje dorëzohet brenda 5 ditësh. Nuk do të pranohen kundërpërgjigje.

¹⁴ Për qëllime të këtij Urdhri, 'deklaratë' duhet të kuptohet sipas përkufizimit në KSC-BC-2020-07, Transkripti i seancës, 19 tetor 2021, f. 937-939; F00334, Trupi Gjykes II, *Vendim në lidhje me Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 29 shtator 2021, para. 85-87.

- ii. brenda 7 ditësh pasi të kenë marrë listën, bëjnë të ditur:
 - a. cilët dëshmitarë synojnë të marrin në pyetje dhe kohëzgjatjen që nevojitet për marrjen në pyetje të secilit dëshmitar;
 - b. kundërshtimet ndaj pranimit të deklaratave të dëshmitarit/transkripteve të intervistave dhe/ose provave materiale, që ZPS-ja propozon të paraqesë përmes dëshmitarëve;
- iii. Ekipet e Mbrojtjes këshillohen mes vete për të diskutuar kuadrin dhe llojin e marrjes në pyetje: (i) për të shmangur përsëritjen e pyetjeve dhe (ii) për t'u pajtuar që një ekip i Mbrojtjes bën të gjitha pyetjet ose pjesën më të madhe të pyetjeve, duke mbajtur parasysh që kjo të mos dëmtojë të drejtat e të akuzuarit për t'u ballafaquar me dëshmitarin kundër tij.

77. Në fund të çdo blloku prej tri javësh të seancave, pala që thërret dëshmitarët njofton Trupin Gjykses dhe palën dhe pjesëmarrësit e tjerë për dëshmitarët që synon të thërrasë gjatë bllokut të ardhshëm prej tri javësh të seancave.

78. Të enjten, në orën 16:00, në çdo javë që vjen para javës në të cilën do të dëgjohen dëshmitarët, pala që thërret dëshmitarët njofton Trupin Gjykses dhe palën dhe pjesëmarrësit e tjerë për dëshmitarët që synon të thërrasë gjatë javës së ardhshme.

79. Pala thirrëse kalon në sistemin elektronik *Legal Workflow* rendin përfundimtar të paraqitjes së provave të saj, jo më vonë se 24 orë para se të dëshmojë dëshmitari, ku të përfshihen dokumentet që synon të përdorë lidhur me dëshmitarin.

80. Është detyrë e palës paraqitëse që të njoftojë Trupin Gjykses, palën dhe pjesëmarrësit e tjerë dhe Zyrën Administrative sa më parë që të jetë e mundshme për ndryshimet në rendin e dëshmitarëve dhe ose për çdo ndryshim të listës së provave materiale (të propozuara) që synon të përdorë me dëshmitarët.

81. Është përgjegjësi e palës paraqitëse të sigurojë që, kur një dëshmitar përfundon dëshminë, dëshmitari tjetër të jetë gati të fillojë të dëshmojë. Nëse një nga dëshmitarët e propozuar nuk është në gjendje të dëshmojë në kohën e përcaktuar apo nëse nuk

merret në pyetje dëshmitari ose nëse marrja në pyetje kryhet më shpejt se pritej, pala paraqitëse mundëson thirrjen e një dëshmitari alternativ për t'i shmangur vonesat në proces. Vetëm ata dëshmitarë për të cilët është dhënë njoftim sipas paragrafit 77 mund të thirren si dëshmitarë alternativë, përveç nëse trupi gjykues jep leje paraprakisht.

82. Është përgjegjësi e palës paraqitëse të dorëzojë listën e provave (të propozuara) që synon të përdorë gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve të saj. Megjithatë, në qoftë se pala paraqitëse bëhet me dije për material shtesë, që dëshiron të përdorë gjatë marrjes në pyetje të atij dëshmitari, pala paraqitëse: (i) njofton pa vonesë palën dhe pjesëmarrësit e tjerë dhe Trupin Gjykses; (ii) parashtron listën përfundimtare të materialit që do të përdoret dhe e kalon materialin shtesë në rendin e paraqitjes së provave jo më vonë se 24 orë para dëshmisë së dëshmitarit. Nëse materiali shtesë që pala paraqitëse dëshiron të përdorë gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit nuk është përfshirë në listën përfundimtare të provave materiale të dorëzuara sipas rregullës 102(1)(b)(iii) ose rregullës 104(5)(c), pala kërkon leje nga Trupi Gjykses për ndryshim të listës së provave materiale. Kur materiali i ri është i rëndësishëm, pala kundërshtare mund të kërkojë shtyrje të seancës ose masa të tjera të nevojshme për t'i mundësuar asaj shqyrtim të mjaftueshëm të materialit dhe përgatitje të efektshme të marrjes në pyetje.

83. Lista me rendin e paraqitjes së të gjitha dokumenteve ose materialeve të tjera që do të përdoren gjatë marrjes në pyetje nga pala tjetër, duhet t'u vihet në dispozicion Trupit Gjykses dhe palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë më së voni menjëherë pas përfundimit të marrjes në pyetje të dëshmitarit. Lista përfshin numrin e provës materiale të provave të cilat Trupi Gjykses i ka pranuar tashmë si prova ose numrin ERN të dokumentit nëse nuk është pranuar. Në listën me rendin e paraqitjes së provave përfshihen edhe dokumente ose materiale të cilat nuk janë nxjerrë më parë, e që janë pjesë e listës së dokumenteve dhe materialeve që do të përdoren gjatë marrjes në pyetje. Pala ose pjesëmarrësi tjetër mund të kërkojë një pauzë të shkurtë për të analizuar materialin e ri.

84. Palët dhe pjesëmarrësit udhëzohen të bien dakord, aty ku është e mundur, për rendin në të cilën do të thirren dëshmitarët javën në vijim. Trupi Gjykses rezervon të drejtën të urdhërojë palët dhe pjesëmarrësit që ta ndryshojnë rendin për të thirrur dëshmitarët të propozuar prej tyre.

D. PËRGATITJA E DËSHMITARËVE

85. Trupi Gjykses lejon përgatitjen e dëshmitarëve në përputhje me parimet e shtjelluara në këtë pjesë.

86. Qëllimi i përgatitjes së dëshmitarit është:

i. Të ndihmojë dëshmitarin i cili do të japë dëshmi gjatë procesit gjyqësor:

- (a) të sigurojë që dëshmitari jep dëshmi që lidhet me lëndën, të saktë dhe të strukturuar; dhe
- (b) të sigurojë mirëqenien e dëshmitarit.

ii. Që pala thirrëse të vlerësojë dhe qartësojë dëshminë e dëshmitarit me qëllim mundësimin e marrjes në pyetje të dëshmitarit gjatë procesit në mënyrë të përqendruar, efikase dhe efektive.

87. Ndalohet çdo tentim për të ndikuar tek dëshmitari që të japë dëshmi për ngjarje faktike të cilat nuk i ka parë ose nuk i ka perceptuar. Nuk lejohen udhëzimi, mësimi ose ushtrimi.

88. Përgatitja e dëshmitarit kryhet me ndershmëri dhe në përputhje me standardet e sjelljes dhe etikës profesionale në fuqi.

89. Përgatitja e dëshmitarit është përgjegjësi e palës thirrëse, e cila vendos për organizimet konkrete në bashkërendim me Zyrën Administrative. Pala thirrëse u kushton vëmendje të veçantë dëshmitarëve të cënueshëm dhe nëse është e nevojshme, Zyra Administrative duhet të jetë në dispozicion për të ndihmuar lidhur me këta dëshmitarë.

90. Gjatë përgatitjes së dëshmitarit, avokati duhet të jetë i shoqëruar nga më së paku një person tjetër i ekipit të palës thirrëse, përveçse kur kjo pamundësohet prej rrethanave të posaçme.
91. Me kërkesë të dëshmitarit, këshilltari i vet juridik lejohet të marrë pjesë në seancën përgatitore.
92. Pala thirrëse merr parasysht sigurinë e dëshmitarit kur vendos se ku do të kryhet përgatitja e dëshmitarit.
93. Pala thirrëse kryen seancën përgatitore pasi të jenë marrë deklaratat, nëse janë marrë, dhe pasi ato t'u jenë dhënë palës dhe pjesëmarrësve të tjerë.
94. Në varësi të disponueshmërisë së dëshmitarit dhe logjistikës së udhëtimit, pala thirrëse përpiqet të kryejë seancat përgatitore sa më shpejt që të jetë e mundur dhe gjithsesi më së paku 24 orë para fillimit të dëshmisë së dëshmitarit.
95. Pala thirrëse mban evidencë për çdo seancë përgatitore, ku përmenden vendi dhe kohëzgjatja e seancës, dhe të pranishmit në seancë. Pas seancës përgatitore të dëshmitarit, pala thirrëse ua dorëzon kopjen e evidencës palës jothirrëse dhe pjesëmarrësve dhe Trupit Gjykses.
96. Së paku 24 orë para fillimit të dëshmisë, pala thirrëse u dorëzon palës jothirrëse dhe pjesëmarrësve dhe Trupit Gjykses të gjithë informacionin që është objekt i detyrimeve të palës për nxjerrje të materialit, përfshirë: (i) sqarime, ndryshime ose korrigjime të dëshmitarit në deklaratat e veta të mëparshme dhe arsyet, nëse ka, të dëshmitarit që përlligjin ndryshimin ose korrigjimin; dhe (ii) informacion të ri të marrë nga dëshmitari. Ky informacion dokumentohet në një shënim dhe i lexohet dëshmitarit, i cili konfirmon nëse ai pasqyron plotësisht dhe saktësisht përshkrimin e vet. Shënimi nënshkruhet nga personi i cili e ka përpiluar dhe u dërgohet Trupit Gjykses, palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave përmes *Legal Workflow*. Nëse pala dëshiron të paraqesë deklaratën e dëshmitarit sipas rregullës 154, para se ta marrë dëshmitarin në pyetje, i kërkon që të konfirmojë, në varësi të korrigjimeve të

përcaktuara në shënim, “se deklarata me shkrim ose transkripti pasqyron saktësisht çfarë ka thënë dhe çfarë do të thoshte po të pyetej” sikurse përcaktohet në rregullën 154. Më pas, pala mund të paraqesë për pranim deklaratën e dëshmitarit dhe shënimin me korrigjime sipas rregullës 154.

97. Gjatë seancave përgatitore, avokati që parashtron pyetje:

- i. përsërit detyrimin e dëshmitarit për të treguar të vërtetën;
- ii. shpjegon qëllimin e seancës përgatitore;
- iii. i jep dëshmitarit mundësinë t’i rishikojë deklaratat e mëparshme të veta;
- iv. i jep dëshmitarit mundësinë të konfirmojë nëse deklaratat e mëparshme të veta, janë të sakta dhe të shpjegojë ndryshimet sipas nevojës; dhe
- v. të bëjë me dije në rast se dëshmitari mendon se informacioni mund të jetë vetinkriminues, që dëshmitarit t’i jepet mundësia të këshillohet me avokat përpara se t’u përgjigjet pyetjeve të tilla;

98. Gjatë seancave përgatitore, avokati që merr në pyetje:

- i. nuk tenton të ndikojë në thelbin e përgjigjeve të dëshmitarit, drejtpërdrejt ose tërthorazi (për shembull ndër të tjera të informojë dëshmitarin lidhur me llojin e provave që do të ndihmonin argumentet e palës thirrëse, të sugjerojë nëse përgjigjet e dëshmitarit janë me vend apo jo, ose t’i bëjë dëshmitarit pyetje sugjeruese të papërshtatshme);
- ii. nuk e ushtron dëshmitarin me pyetjet dhe përgjigjet e pritura gjatë dhënies së dëshmisë në sallë të gjyqit, në mënyrë që dëshmitari t’i mësojë përmendësh pyetjet dhe përgjigjet;
- iii. nuk informon dëshmitarin lidhur me dëshmi të dëshmitarëve të tjerë (përfshirë dëshmi gojore dhe deklarata të mëparshme të dokumentuara të dëshmitarëve të tjerë); dhe

iv. nuk ia bën të ditur informacionin që është objekt i masave mbrojtëse të urdhëruara nga Trupi Gjykses.

99. Kur personi është informuar për të drejtat dhe detyrimet sipas rregullës 43 si pjesë e hetimit dhe është intervistuar nga ZPS-ja përsëri përpara se të japë dëshmi, ZPS-ja e përsërit njoftimin kur vazhdon të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm se personi ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara. Kur një person është intervistuar gjatë hetimit pa iu dhënë ky njoftim, por në kohën e seancës përgatitore ZPS-ja ka arsye për të besuar se personi ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, ZPS-ja i jep personit njoftimin sipas rregullës 43.

E. RENDI I MARRJES NË PYETJE

100. Kur ZPS-ja thërret një dëshmitar, rendi i marrjes në pyetje të këtij dëshmitari është si në vijim:

- ZPS-ja
- Mbrojtësi i Viktimave, me leje të Trupit Gjykses
- Mbrojtësi i të akuzuarit

101. Kur mbrojtësi i të akuzuarit thërret një dëshmitar, rendi i marrjes në pyetje të këtij dëshmitari është si në vijim :

- mbrojtësi i të akuzuarit
- mbrojtësit e të akuzuarve të tjerë
- ZPS-ja
- Mbrojtësi i Viktimave, me leje të Trupit Gjykses

102. Kryegjykatësi mund të ndryshojë rendin e marrjes në pyetje, kur kjo është në interes të drejtësisë.

F. MARRJA NË PYETJE E DËSHMITARËVE

103. Pyetjet e palëve dhe të pjesëmarrësve përqendrohen në pyetje që lidhen rreptësisht me procesin gjyqësor.

104. Kur një palë merr në pyetje dëshmitarin dhe paraqet material gjatë marrjes në pyetje, ajo përqendrohet në pretendimet e përfshira në Aktakuzë dhe argumente të vlefshme të cilat Mbrojtja mund t'i shtjellojë më tej në përgjigje. Palët dhe pjesëmarrësit nuk paraqesin pyetje, ose nuk paraqesin prova materiale që kanë për synim paraqitjen e mbrojtjes *tu quoque* ose ndonjë argument mbrojtës tjetër të cilin Trupi Gjyqësor e ka gjykuar të pavlefshëm. Ngjashëm, pyetjet në lidhje me drejtësinë dhe ligjshmërinë e luftës nuk kanë lidhje me këtë proces gjyqësor dhe nuk do të lejohen, përveç nëse vërtetohet qartësisht se janë të rëndësishme për një fakt që lidhet me çështjen gjyqësore. Rrjedhimisht, palët dhe pjesëmarrësit duhet të jenë të gatshëm të japin sqarime lidhur me bazën dhe arsyen për pyetje të tilla, nëse kërkon Trupi Gjyqësor.

105. Një palë e organizon marrjen në pyetje të dëshmitarit të vet në mënyrë të tillë që më të shumtat e pyetjeve të mund të dëgjohen në seancë publike; pyetjet që kërkojnë nga Trupi Gjyqësor të kalojnë në seancë të mbyllur ose private duhet të grupohen bashkë sa më shumë që të jetë e mundur.

106. Pyetjet nga pala jothirrëse përqendrohen në temat e përcaktuara në rregullën 143(3), pra në: (i) / temën e pyetjeve të palës thirrëse dhe/ose (ii) aspekte që ndikojnë në besueshmërinë e dëshmitarit. Në rast se dëshmitari është në gjendje të japë dëshmi që ka lidhje me argumentin e palës jothirrëse, dëshmitari mund të pyetet në lidhje me atë temë, me kusht që pala jothirrëse t'i shpjegojë dëshmitarit llojin e argumentit. Pala jothirrëse bën çmos të shmangë pyetje të panevojshme, që nuk lidhen me lëndën ose që përsëriten. Rrjedhimisht, mbrojtësit e të akuzuarve këshillohen të bashkërendojnë marrjen në pyetje me mbrojtës të tjerë, kur kjo është e mundur dhe në përputhje me të

drejtat e të akuzuarve, të caktojnë një mbrojtës për të marrë në pyetje dëshmitarin në lidhje me aspekte të përbashkëta, me qëllim shmangien e pyetjeve përsëritëse.

107. Në përputhje me rregullën 143(2), kur dëshmitari jep dëshmi të pafavorshme për palën thirrëse, nuk u përgjigjet pyetjeve drejtpërdrejt ose kundërshton deklaratat e veta të mëparshme, pala thirrëse mund t'i kërkojë Trupit Gjykses leje që: (i) t'i paraqesë dëshmitarit deklaratën e mëparshme, kur është e përshtatshme; (ii) të pranohet kjo deklaratë; dhe/ose (iii) t'i bëjë dëshmitarit pyetje sugjeruese në lidhje me aspektet që ndikohen nga një prej rrethanave të lartpërmendura.

108. Rendi i marrjes në pyetje të dëshmitarëve të ZPS-së nga ekipet e Mbrojtjes shkon sipas renditjes së klientëve të tyre në Aktakuzë, përveç nëse mbrojtësit pajtohen mes vete për rend tjetër.

109. Trupi Gjykses ushtron kontroll të rreptë mbi marrjen në pyetje që duket se përsërit pyetjet që i janë parashtruar dëshmitarit nga mbrojtësi i një të akuzuari tjetër.

110. Trupi Gjykses për momentin nuk do të caktojë kufizim kohor për marrje në pyetje të dëshmitarëve nga pala jothirrëse. Megjithatë, palët dhe pjesëmarrësit udhëzohen të përdorin kohën e tyre në mënyrë efektive. Trupi Gjykses rezervon përgjegjësinë për caktimin e kufizimit kohor nëse kjo bëhet e domosdoshme për garantimin e shpejtësisë së procesit gjyqësor.

111. Trupi Gjykses lejon pyetje shtesë në përputhje me rregullën 127(3) vetëm për aspekte që dalin gjatë marrjes në pyetje nga pala jothirrëse. Pyetje shtesë nga pala thirrëse për aspekte të reja mund të parashtrohen vetëm me leje të Trupit Gjykses.

112. Trupi Gjykses lejon pyetje shtesë nga pala jothirrëse vetëm nëse ndonjë palë ose pjesëmarrës paraqet material të ri gjatë pyetjeve shtesë nga pala thirrëse ose marrjes në pyetje nga pala jothirrëse ose pjesëmarrësi. Në këto rrethana, pala jothirrëse ka të drejtë të marrë dëshmitarin më tej në pyetje lidhur me materialin e ri. Kur dalin aspekte tërësisht të reja si rrjedhojë e pyetjeve për dëshmitarin nga Trupi Gjykses, pas marrjes në pyetje nga pala jothirrëse dhe pyetjeve shtesë nga pala thirrëse, çdo palë

mund të bëjë kërkesë me gojë për leje për të marrë në pyetje dëshmitarin më tej lidhur me aspektet e reja.

113. Palët dhe pjesëmarrësit shmangin pyetje të gjata dhe të ndërlikuara të cilat mund të ngatërrojnë dëshmitarin, dhe dëshmitarit i parashtrihen pyetjet me rend e një nga një, e jo njëherësh. Palët dhe pjesëmarrësit mbajnë parasysh nevojën që përkthyesit të përkthejnë pyetjet dhe përgjigjet për të siguruar që transkripti të pasqyrojë pyetjet dhe përgjigjet në tërësi dhe me saktësi.

114. Trupi Gjykses udhëzon palët dhe pjesëmarrësit të sigurojnë që dëshmitarit t'i drejtohen pyetjet nga një mbrojtës për një të akuzuar, dhe sa i përket ZPS-së, një prokuror në emër të ZPS-së.

G. KUNDËRSHTIMET

115. Cilado palë që dëshiron të kundërshtojë një pyetje në kohën që dëshmitari është duke dëshmuar, duhet të çohet dhe të paraqesë shkurtimisht kundërshtimin. Të gjitha kundërshtimet, komentet dhe deklarime të tjera në sallë të gjyqit i drejtohen Trupit Gjykses e jo mbrojtësit të palës tjetër.

116. Kundërshtimet ndaj pranimi të një dokumenti ose llojit të pyetjeve bëhen duke paraqitur shkurtimisht bazën e kundërshtimit. Pala që kundërshton duhet të shmangë parashtrime të gjata, përveçse nëse udhëzohet nga Trupi Gjykses. Në veçanti, pala që kundërshton nuk bën "kundërshtim sugjestiv" që i jep udhëzim ose informacion dëshmitarit të pranishëm në sallë të gjyqit. Kur pala kundërshtuese duhet të paraqesë një kundërshtim që ka gjasë t'i japë dëshmitarit udhëzime ose informacion, ajo i kërkon Trupit Gjykses që të nxjerrë dëshmitarin jashtë sallës së gjyqit, në mënyrë që ta paraqesë kundërshtimin plotësisht.

117. Përveçse nëse Trupi Gjykses vendos ndryshe, vendimin lidhur me kundërshtimin ai e lëshon gojarisht dhe menjëherë.

118. Kur pala pret të kundërshtojë dëshminë e dëshmitarit ose provën materiale të propozuar mbi bazën e një kundërshtim faktik ose juridik veçanërisht kompleks, parimisht ajo u paraqet njoftim palës dhe pjesëmarrësve të tjerë dhe Trupit Gjykses, në të cilin përshkruan përgjithësisht kundërshtimin, së bashku me burimin mbështetës përkatës, së paku një ditë para datës së fillimit të dëshmisë ose paraqitjes së provës materiale të propozuar. Trupi Gjykses merr vendim lidhur me kundërshtimin pasi të ketë dëgjuar palët dhe pjesëmarrësit .

119. Në përgjithësi, Trupi Gjykses shqyrton parashtrimet për pranueshmërinë e provave materiale të palëve dhe të pjesëmarrësve dhe vendos lidhur me to në kohën kur provat materiale paraqiten si prova. Kur është më praktike, Trupi Gjykses mund të shtyjë marrjen e vendimit lidhur me pranueshmërinë deri në përfundim të dëshmisë së dëshmitarit.

H. PËRDORIMI I DEKLARATAVE TË MËPARSHME

120. Kur dëshmitarit nuk i kujtohen qartë rrethanat përkatëse ose jep dëshmi në kundërshtim me deklaratat e veta të mëparshme, një deklaratë ose transkript i mëparshëm i dëshmitarit mund të përdoret për t'ia freskuar kujtesën dëshmitarit, pavarësisht se a është pranuar apo nuk është pranuar si provë. Kur dëshmitarit i parashtrohet një gjë që ka thënë më parë gjatë dëshmisë, ose në një deklaratë të mëparshme me shkrim, palët dhe pjesëmarrësit shmangin perifrachimet e dëshmitarit dhe citojnë drejtpërdrejt transkriptin ose deklaratën e mëparshme, me faqet dhe numrat e rreshtave përkatës. Palët dhe pjesëmarrësit mund të kërkojnë pranimin e ndonjë deklaratë mospërputhëse të mëparshme për vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarit, si dhe për vërtetësinë e përmbajtjes së saj ose për qëllime të tjera në pajtim me kompetencën diskrecionale të Trupit Gjykses.

I. DËSHMITARËT EKSPERTË

121. Në përputhje me rregullën 149, pala thirrëse dorëzon, bashkë me aktekspertizën, një përmbledhje të përgjithshme të udhëzimeve të palës thirrëse për ekspertin përpara se eksperti të dorëzojë versionin e parë jopërfundimtar të aktekspertizës, dhe udhëzime të mëtejshme për të nga pala thirrëse pas marrjes së versionit jopërfundimtar të parë ose versioneve jopërfundimtare të mëtejshme.

122. Pala thirrëse kërkon leje për ndryshim të listës së vet të dëshmitarëve për të shtuar një ekspert, ndryshuar ose plotësuar një aktekspertizë, ose për t'i bashkëlidhur shtojcë, vetëm pasi të ketë treguar arsye të vlefshme. Leja jepet para dhënies së udhëzimeve për dëshmitarë të tillë. Rrjedhimisht, ZPS-ja udhëzohet të sigurojë që aktekspertizat e ekspertëve që synon të thërrasë, të përfundohen dhe të jenë të gatshme për pranim si prova përpara fillimit të paraqitjes së provave të saj. I njëjti standard vlen edhe për Mbrojtjen, nëse Trupi Gjykes konstaton se për një ose disa të akuzuar akuzat mbeten në fuqi sipas rregullës 130. Në këtë rast, Mbrojtja përpilon dhe nxjerr aktekspertizat e propozuara brenda 10 ditësh nga vendimi sipas rregullës 130.

123. Kur dëshmitari ekspert paraqet aktekspertizën, ajo mund të pranohet si provë në varësi të kriterit të lidhjes me lëndën dhe vlerës provuese. Materiali nga burimet do të pranohet në bazë të kërkesës, kur përliqet.

124. Dëshmitarët ekspertë të propozuar përmbushin rreptësisht kriterin e ekspertizës dhe të paanësisë. Trupi Gjykes nuk do të dëgjojë si dëshmitarë ekspertë persona që nuk kanë ekspertizë që Trupi Gjykes ka, e as nuk do t'i konsiderojë si ekspertë personat e punësuar si personel ose si anëtarë ekipi të një pale.

125. Personat që nuk përmbushin kriteret e mësipërme, gjithsesi mund të thirren si dëshmitarë për të dhënë dëshmi lidhur me fakte dhe rrethana relevante për hetimin e çështjes gjyqësore, ose të japin dëshmi në lidhje me dokumentet e paraqitura në prova. Trupi Gjykes nuk do të autorizojë këta dëshmitarë që të ndërhyjnë në përgjegjësitë e veta për konstatim faktesh.

126. Trupi Gjykses mund të udhëzojë ekipet e Mbrojtjes të thërrasin cilindo prej dëshmitarëve ekspertëve në listat e dëshmitarëve të tyre, në fazën e hershme të paraqitjes së provave të Mbrojtjes për secilin prej të akuzuarve.

127. Pasi të ketë dëgjuar dëshmitarët ekspertë të thirrur nga palët dhe pjesëmarrësit, Trupi Gjykses mund të udhëzojë dhe të thërrasë, *proprio motu*, dëshmitarë ekspertë shtesë në përputhje me rregullën 132, ose të udhëzojë palët dhe pjesëmarrësit të udhëzojnë bashkërisht dëshmitarë ekspertë shtesë.

XVI. KONFERENCAT MBI ECURINË LIDHUR ME ASPEKTE PROCEDURALE

128. Trupi Gjykses dëshiron të garantojë që procesi gjyqësor të përqendrohet kryesisht në aspekte juridike dhe faktike që lidhen me lëndën kundër të akuzuarve. Megjithëse gjatë procesit mund të dalin aspekte procedurale të caktuara (p.sh. probleme me nxjerrje materiali, redaktim materiali ose masa mbrojtëse), Trupi Gjykses dëshiron të garantojë që ato të mos zgjasin ose vonojnë panevojshëm ecurinë e gjykimit. Për këtë arsye, Trupi Gjykses udhëzon palët dhe pjesëmarrësit që të përpiqen të zgjidhin këto mospajtime përpara se t'ia paraqesin ato Trupit Gjykses. Sipas nevojës dhe rregullës 116(5), Trupi Gjykses mund të mbajë konferenca mbi ecurinë për aspekte procedurale për të zgjidhur çfarëdo problemi që palët dhe pjesëmarrësit nuk mund të zgjidhin mes vete. Kur dalin këto probleme, palët dhe pjesëmarrësit njoftojnë Trupin Gjykses menjëherë lidhur me to, me llojin e përgjithshëm dhe mënyrën e propozuar të zgjidhjes.

XVII. PRANIA NË SALLË TË GJYQIT DHE PËRFAQËSIMI NGA MBROJTËSI

129. Parimisht të pranishëm në sallën e gjyqit janë mbrojtësit dhe administratorët e çështjes. Nëse një palë dëshiron të sjellë në sallën e gjyqit një anëtar tjetër të ekipit, ajo duhet t'i njoftojë 24 orë përpara palën dhe pjesëmarrësit e tjerë.

130. Mbrojtësi i të akuzuarit siguron që së paku një mbrojtës të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës në sallë të gjyqit për të përfaqësuar të akuzuarin. Trupi Gjykses nuk do të shtyjë seancën gjyqësore për shkak të mungesës së kryembrojtësit ose bashkëmbrojtësit.¹⁵

131. Trupi Gjykses mund të urdhërojë që prania në sallën e gjyqit dhe/ose qasja në transkriptet e seancave gjyqësore të lejohen vetëm për mbrojtësit dhe anëtarët e identifikuar të palëve dhe pjesëmarrësve.

XVIII. EVIDENTIMI I KOHËS

132. Zyra Administrative është përgjegjëse për evidentimin e kohës së përdorur gjatë dëshmisë së secilit dëshmitar:

- i. nga pala ose pjesëmarrësi thirrës për marrje në pyetje nga ta, duke shënuar për çdonjërin prej tyre nëse dëshmia u dha në formë të deklaratës sipas rregullës 154;
- ii. nga çdo palë ose pjesëmarrës që merr në pyetje dëshmitarin e palës tjetër;
- iii. nga pala ose pjesëmarrësi përkatës për pyetje shtesë;
- iv. nga gjykatësit për pyetjet e drejtuara dëshmitarëve; dhe
- v. për të gjitha aspektet të tjera, përfshirë procedurale dhe administrative.

133. Zyra Administrative në bashkëpunim me Trupin Gjykses përpilon rregullisht raportet për kohën e përdorur, të cilave u dorëzohen palëve dhe pjesëmarrësve kohë pas kohe.

134. Trupi Gjykses monitoron vazhdimisht kohën e përdorur dhe sipas nevojës, lëshon urdhra të lidhur me kohën që përdorin ZPS-ja ose të akuzuarit.

¹⁵ KSC-BC-2020-07, Transkripti i seancës, 7 dhjetor 2021, f. 2144-2146.

XIX. DOSJET GJYQËSORE PËRFUNDIMTARE

135. Dosjet gjyqësore përfundimtare dorëzohen në përputhje me rregullën 134(b) në datën e caktuar nga Trupi Gjyqësor. Dosjet gjyqësore përfundimtare të të gjitha palëve dhe pjesëmarrësve do të dorëzohen më të njëjtën datë.

136. Secila palë dhe pjesëmarrës evidenton konkretisht provat materiale dhe pjesët e transkriptit të fazës përkatëse të procesit në të cilat mbështetet. Palët dhe pjesëmarrësit nuk mbajnë të papërfshirë në Dosjen Gjyqësore Përfundimtare ndonjë argument për qëllime taktike në lidhje me një provë materiale ose pjesë të transkriptit, për ta ngritur atë në fazën vijuese të procesit. Kopjet e referencave dhe burimeve që nuk janë të disponueshme menjëherë mund të dorëzohen si shtojca bashkë me dosjen.

XX. SISTEMI ELEKTRONIK *LEGAL WORKFLOW*

137. Gjatë këtij gjykimi do të përdoret sistemi elektronik *Legal Workflow*. Përgjithësisht të gjitha dokumentet kalojnë nëpërmjet këtij sistemi. Palët ose pjesëmarrësit mund të përdorin kopje fizike të dokumenteve vetëm kur për shkak të rrethanave të paparashikueshme, nuk kanë mundur t'i kalojnë dokumentet në *Legal Workflow* ose kur përdorimi i tyre fizik është i domosdoshëm në sallë të gjyqit.

138. Kur lejohen kopje fizike të dokumenteve, pala dhe pjesëmarrësi që i paraqet ka përgjegjësinë për t'i vënë ato në dispozicion të Trupit Gjyqësor, dëshmitarit, palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë, Zyrës Administrative dhe përkthyesve.